



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 13.07.2017

**Vendim**  
**Nr. 76, datë 13.07.2017**

**PËR FINANCIMIN E LËVIZJEVE JASHTË VENDIT TË STAFIT TË  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 3, pika 3, shkronja c, nenit 38 në Ligjin 80/20 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit Nr 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", si dhe në bazë të Udhëzimit Nr. 22, datë 10.07.2013 'Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.07.2017

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Zv/rektorit për Zhvillim Institucional dhe Komunikim dhe Zv/rektorit për Kërkimin Shkencor me nr. 811/3 prot., datë 06.06 2017 si më poshtë:
  - a) Për cdo udhëtim jashtë shtetit pjesëmarrësit duhet të parashetrojnë qëllimin e pjesëmarrjes dhe përfitimet e mundshme të institucionit.
  - b) Nuk lejohet qëndrimi në hotel me vlerë më shumë se 60 euro (Në rast të tejkalimit të kësaj vlere, pjesëmarrësi do të paguajë vetë pjesën tjetër të shpenzimit.).
  - c) Pjesëmarrësve mund t'u parapaguhet vetëm bileta e udhëtimit.
  - d) Pjesëmarrësit duhet të kenë informuar të paktën 1 (një) muaj para organizimit të konferencës/takimit (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e *fee-s* dhe biletave me vlerë sa më të ulët) (përveçse në raste të jashtëzakonshme).
  - e) Të shkruajnë brenda 2 (dy) javëve pas ardhjes së tyre një relacion të shkurtër mbi pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e zhvilluar.



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

---

f) Akomodimi në një nga hotelet e propozuara nga organizatorët nuk do të thotë që është i detyrueshëm për pjesëmarrësit e institucionit.

g) Të përpiqen të vendosin marrëdhënie me kolegë dhe Universitete homologe.

\* Përjashtohen nga ky propozim vetëm Rektori dhe Dekanët e Universitetit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Drejtorja e Financës dhe Realizimi të Buxhetit, Zv/rektori për Zhvillim Institucional dhe Komunikim dhe Zv/rektori për Kërkimin Shkencor.
3. Vendimit regjistrohet dhe arkivohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.